

PRANUAR ME: 21/08/2024  
ACCEPTED ON:  
PRIMLJENO: 021362  
No. Nr. Qr:



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



### PROCESVERBAL

i mbledhjes së -IV- (katërt) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 21.05.2024 dhe filloi në ora: 10:15.

**Në mbledhje morë pjesë:** Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Arlindë Rudi, Hamit Lima, përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

**Mungon:** Sadik Vrenezi (PDK) me arsye.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -IV- (katërt) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 6 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Para se të fillojmë tek rendi I ditës kërkoj që pika e nëntë Plani i Komitetit për shëndetësi për vitin 2024 të hiqet nga rendi I ditës sepse në KPF-ë është miratuar dhe e kemi në kuvend. Kush është për që pika e 9 të hiqet nga rendi i ditës?

Me vota unanime të 6 anëtarëve kjo pikë largohet nga rendi i ditës.

A keni diqka për rend të ditës?

Nëse nuk ka diskutues e hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për miratimin e rendit të ditës? Me vota unanime të 6 anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

#### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (mbledhja e dytë dhe e tretë) për vitin
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/610 datë 15.05.2024 të Kryetarit të Komunës
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/511 datë 26.04.2024 të Kryetarit të Komunës
4. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës (Janar- Dhjetor ) për vitin 2023
5. Plani vjetor i Prokurimit publik për vitin 2024
6. Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor Janar-Mars për vitin 2024.
7. Bartja e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin fiskal 2024
8. Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi për vitin 2023

9. Raporti i Punës së Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023
10. Plani i Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2024
11. Shqyrtimi i kërkesave
12. Të ndryshme

#### **Pika e parë**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, përkatësisht të mbledhjes së dytë dhe të tretë e KPF-së.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** A keni diqka rreth procesverbalit?

Nëse nuk ka diskutues, kush është për miratimin e këtyre dy procesverbaleve?

Me vota unanime të 6 anëtarëve, miratohen këto dy procesverbale.

#### **Pika e dytë**

Kërkesa nr.01/610 datë:15.05.2024 e kryetarit të komunës.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kemi të bëjmë me formimin e Këshillit organizativ për krenntimin e 16 qeshorit. Kush është për rekomandim për kuvend pikën e dytë të rendit të ditës?

Me vota unanime, miratohet pika e dytë e rendit të ditës.

#### **Pika e tretë**

Kërkesa nr.01/511 datë:26.04.2024.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kemi kërkesë për shpallje zonë me interes ë përgjithshëm me fillimin e procedurës për bartjen e pronësisë së menaxhuar nga Institucionet qendrore Agjensioni Kosovar i privatizimit në emër dhe pronësi të komunës së Malishevës. Nga materiali e keni parë që bëhet fjalë për 4 parcela. Drejtori Bashkim është këtu dhe na sqaron më mirë.

**Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë- Bashkim Krasniqi:** Ne paraprakisht kemi bërë një kërkesë në Agjensionin Kosovar të Privatizimit dhe kemi kërkuar që të na jepet një pëlqim për hapjen e rrugës si tranzit që është pas gjykate tek gjamia dhe del tek stacioni i policisë, mirëpo Agjensioni Pyjor na ka kthyer një shkrim që së pari të shpallet zonë me interes publik dhe të fillohet procedura e shpronësimit. Ne i kemi marrur këto parcela dhe i kemi bërë matjet e nevojshme, por përveq këtyre kemi futur dhe disa parcela që janë me interes për komunën e Malishevës.

Sa i përket parcelës 492-1 me sipërfaqe 40 ari e 81m-katror është prona ku janë të ndërtuara objektet e komunës, kjo pronë dhe më herët është shpallur zonë me interes publik por ka pësuar ndryshime më vonë për këtë arsye duhet të fillohet dhe një herë sepse ka ndryshuar nr. dhe të fillohet nga zero. Prona tjetër është 890-1 me sipërfaqe prej 15 ari e 58m është te ish objekti që ka qenë biblioteka më herët. Parcela tjetër është 507-1 me 24 ari, kjo është duke u shfrytëzuar rruga që është hapur përkohësisht dhe përveq kësaj është dhe një parcel që sillet rreth e rreth stacionit të autobusëve.

Parcesa tjetër është me 25 ari. Parcela nr 5 është 501 me 33 fillon nga varrezat këtu të Malishevës dhe vazhdon deri tek objekti I Delfinës është 13 ari. Faleminderit!

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Veton Zogaj:** Drejtor, në seacë të na sillni dhe shkresa që i'a ke dërgu AKP-së dhe përgjigja e tyre se çka kanë kërku.

Përveq kësaj liste, prej pesë pronave, a kemi dhe prona të tjera në qytet që shfrytëzohen nga komuna, por që ende nuk e kanë statusin e definun a janë të AKP-së apo janë në menaxhim të dikujt tjetër. Nëse ka prona tjera në të cilat i kemi ndërtu qoftë institucionet ose shfrytëzohen prej komune, është mirë me sjellë atë listë komplet dhe me përfundu si vendim me të gjitha dhe jo pjesë pjesë.

E kam pak të paqart te ky parkingu, sepse ai parking është shfrytëzuar privatisht. Drejtor, aty është një biznes dhe ajo pjesa e shtruar me kocka që del në rrugën "Ibrahim Mazreku" a është në kuadër të kësaj. A është pronë private apo publike?

**Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë- Bashkim Krasniqi:** Ajo është pronë private.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/511 datë:26.04.2024? Me vota uananine, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

#### **Pika e katërt**

Raporti vjetor i kryetarit të komunës janar-dhjetor për vitin 2023.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Raporti nuk na ka ardhur nga zyra e kryetarit dhe pse kemi pritur që sot do e sjellin në mbledhje, për këtë arsye e kemi futur në rend të ditës.

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit- Muharrem Morina:** Unë bisedova me Blertën dhe për shkak të mungesës së kryetarit Raporti nuk është nënshkruar dhe rekomandoj që me fut në rend të ditës. sepse është një afat i fundit ligjor për me sqaru si Raport.

**Veton Zogaj:** Nuk është në rregull pa dokument me rekomandu për kuvend. Më mirë do ishte me sjellë në kuvend dhe aty e futim në rend të ditës si kërkesë.

**Gentianë Hoti:** Nëse e kalojmë tani është më mirë sepse na vjen me material dhe e shohim se çka ka në Raport.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim të kërkesës nr.01/511 datë:26.04.2024? Për:4 Kundër:0 Abstenim:2, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

#### **Pika e pestë**

Plani vjetor i prokurimit publik

**Veton Zogaj:** Jemi vonë me Planin e prokurimit dhe nëse nuk shkon dhe kësaj here në kuvend i humb dhe rëndësia e tij. Numër 46 furnizime dhe montime të paisjeve të sistemit të alarmit, për

qfarë sisteme po bëhet fjalë.

Inicimi i procedurave për blerjen e librave për bibliotekën Sokol Kryeziu, nuk e di si keni me blerë libra kur ai objekt është i parapam me u rrënu.

Realizimi i vizitës me karakter historik dhe arsimor 10.000E është shifer e lartë.

Shërbimi i transportit për fshatin Panorç- a është për nxënës kjo.

Spërkatja selektive- jemi vonë unë kam pas kritik për këtë.

Plan projekti për themelimin e strukturës komunale për mbrojtje shpëtim dhe ndihmë- 200.000E, çka është kjo?

**Zyrtar i Prokurimit Shkelzen Bytyqi-** Drejtorit i sjellin, ne vetëm i zbatojmë.

**Hamit Lima:** Tek mirëmbajtja teknike e shkollave, furnizimi dhe montimi i gjamave- këtu është tenderi i marrur.

**Zyrtar nga prokurimi Shkelzen Bytyqi:** Qe dy vite nuk ka tender dhe tani është e planifikuar.

**Hamit Lima:** Tek renovimi i shkollave- shkolla në Astrazup është bërë tash vonë, pse duhet renovim. Renovimet, a i bëjnë kërkesat drejtorët apo i vlersoni ju.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për Kuvend, Planin e prokurimit? Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Pika e gjashtë**

Raportit financiar tre mujor janar-mars 2024.

**Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaçi:** Në bazë të të hyrave vetanake nuk janë të prezantuara të hyrat nga gjobat në komunikacion dhe nga gjykata, sepse raportimi nga ministria ka qenë i vonuar dhe nuk kemi mundur me i fut në raport.

**Veton Zogaj:** Tek të hyrat në mënyrë analitike shihet qartë që disa kategori në raport me 2023 në periudhën e njëjtë kohore ka disa ndryshime. Te certifikatat e lindjes në 2024 janë 146E, në vitin 2023 në periudhën e njëjtë kohore ka qenë zero.

Te certifikatat e tjera që hynë shumë lloje të certifikatave dhe këtu për 2000 e diqka janë ramje. Taksa për mjete motorike ka ngritje. Taksa komunale për ushtrim të veprimtarisë, 3000E kanë qenë në vitin 2023, ndërsa tani është 1500E, është përgjysmim.

Gjoba nga inspektoriati është shumë e ulët, 375 ka qenë në vitin 2023 ndërsa në vitin 2024 është 105 euro.

Unë shpesh e kam kritiku këtë drejtori të inspektoriatit dhe drejtorin, ka thënë që i kanë gjobit biznese që si kanë respektu vendimet e komunës, por shumat këtu spo flasin ashtu.

Shfrytëzimi i pronës publike është 914E ndërsa në vitin 2023 janë 7311. Tek tatami në pronë kemi rënje në raport me vitin 2023. Licenca tjera për afarizëm e kemi zero. Pranimi Teknik 1 lokalit ose objektit është zero. A bëhet fjalë për objekte publike që i ndërtojm.

**Zyrtar ligjor i Kuvendit Muharrem Morina:** Ligji i ndërtimit e specifikon këtë, taksa nuk pagujn objektet publike, leje ndërtimore lëshohet shkolla, spitale, ndërsa atë që po thua ti duhet pranim teknik i objekteve, ai që e ndërton objektin e bënë kërkesën ne Kadastër dhe pastaj Bashkimi ja kërkon lejen e pranimit teknik, në mënyrë që me rexhistru në Kadastër.

**Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaçi:** Çertifikata e lindjes 146 është kodi i kësaj certifikate që jepet për të jashtëm, ndërsa të gjitha certifikatat e tjera hynë me këtë kod. Tek tatimi qdo taks është periudhë, zakonisht të hyrat nga taksat dhe tatami në pronë periudha më e madhe është muaji prill. Shfrytëzimi i pronës publike, dallimi që e përmende dhe këtu është pagesa psh tek bazeni sepse ai e ka periudhën se kur duhet ta kryej pagesën.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për kuvend pikën e gjashtë?  
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

#### **Pika e shtatë**

**Bartja e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin fiskal 2024**

**Veton Zogaj:** Dhe vitin e ardhshëm është projekti i sheshit i parapamë, deri në qfarë mase janë përfundur procedurat e pagesës. A është përfunduar gjysma e shumës totale?

I kemi lënë pak keq shumicën e projekteve tjera sepse sa herë po ka bartje po shkon vetëm në këtë projekt.

Herën e fundit kur e kemi bërë një bartje të mjeteve, 30.000E i kemi ndarë për një kategori të veçant, unë si asambleistë nuk e kam asnjë informacion se qka ka ndodhur me ato mjete dhe në anën tjetër ato mjete që janë destinuar për ato pagesa nuk janë krye dhe mjetet nuk e dimë ku janë.

**Drejtori për Buxhet e Financa Blerim Thaçi:** Nesë barten dhe këto mjete dhe planifikimi i buxhetit për projekt të këtij viti që është realizuar pagesa janë krye rreth 2.000.000.00E për këtë vit. Nëse realizohen këto dhe vitin e kaluar, këtë vit e kalojmë dalim 5.1 kontratë. Tek pjesa e 30.000E, kjo është puna që kam pasur me më shumë presion për pagesën e Komisioneve. Është mirë të bëhen 3 asambleista bashkë me mua të shkojmë në ministri drejtpërdrejtë se si me u realizuar këto pagesa, sepse mjete ka.

**Veton Zogaj:** Sa i përket këtij takimi unë jam i gatshëm kur do që e caktoni ju.

**Hamit Lima:** Operatorët që janë duke kryer punime në sheshe, a janë duke ju kryer pagesat me rregull, sepse disa ditë është ndaluar puna për shkak të mos pagesës.

**Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi:** Në shesh asnjë minut nuk është ndaluar puna. I vetmi operator që ka pasur arsye për dy ditë e ka ndaluar furnizimin me karburant ka pas arsye sepse kemi pasur obligim. Asnjë operator tjetër nuk i ka ndaluar punimet.

**Hamit Lima:** Shumë rrugë dhe kanalizime janë mbetur mbrapa.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për që të rekomandohet për kuvend bartja e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin fiskal 2024?  
Me vota unanime, kjo pikë kalon për Kuvend.

**Pika e tetë**

**Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi për vitin 2023**

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kërkoj që këtë pikë ta rekomandojm për Kuvend. Kush është për?  
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Pika e nëntë**

**Raporti i Punës së Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023**

**Hamit Lima:** Sa i përket rastit të bunarve me Katarin ka pasur familje me katër rroga kanë hupur bunar, më mirë do kishe qenë në ambulant të hapet një ose në ndonjë shkollë. Sa i përket elementeve të bujqësisë kanë marrur shumë, ndërsa persona që punojnë me bujqësi nuk përfitojnë.  
Shumë persona kanë marrur sera që as nuk i kanë montu. Bujqësia është katastrof.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është Raporti i Drejtorisë së Bujqësisë të shtyhet për mbledhjen e radhës?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

**Pika e dhjetë**

**Plani i Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2024**

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?  
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Shqyrtimi i kërkesave**

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kërkesa 02/207, për kompensimin e pronës private me pronë publike sipas Ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të paluajtshme të komunës. Me aktgjykimin nr.C.nr.748/21 më është e njohur e drejta e pronësisë në sipërfaqe prej 2300M në pjesën e njësisë kadastrale P-72310047-00982-6, në vendin e quajtur Gërmiza të shkolla në sipërfaqe prej 8846m dhe e pjesës së pronësis me sipërfaqe 241m e cila gjendet në zonën kadastrale në Malishevë. Duke pasur parasysh se prona mbi të cilën e kam fituar të drejtën e pronësisë gjendet në oborrin e shtëpisë së shëndetit QKMF në Malishevë, kërkoj nga ana e juaj që të filloni procedurën e këmbimit.

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Prona Bashkim Krasniqi:** Ne e kemi pranuar një aktgjykim që ju ka njohur e drejta e pronësisë Hazir Tredhaku dhe në momentin që e ke aktgjykimin je i obligun me ja rexhistru të drejtën. I ka dy sipërfaqe njëra është 23 ari që është pikërisht në oborr të QKMF-së dhe 2 ari e 41m është para objektit të Kedsit. Është parë e nevojshme që të fillohet menjëherë të shpallet me interes për komunën dhe nëse kemi mundësi me bërë këmbim të pronës, me ja ofru dhe komuna pronat e vetë që mos me leju që ky me hy në posedim faktik. Gjykata para një kohe ka kërkuar nga ne se si kjo pronë është në emër të komunës, na prej që kemi shërbime kjo figuron në emër të komunës mirëpo pala pretendon se asnjëherë nuk është kompenzu prona kur është marrur nga pusheti i atëhershëm dhe mbi bazën e këti fakti gjykata ja ka njoft të drejtën e pronësisë.

**Hamit Lima:** Drejtor, si ka mundësi që po ja nis po punon me një vend që nuk është në emër të komunës ose ka qenë konteks gjyqësor. A ka qenë konteks gjyqësor kur është fillu ai objekt apo pas fillimit të objektit.

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Bashkim Krasniqi:** Nga lokalet ku janë përballë Gjinnazit e deri tek servis Xeni ka qenë pronë në emër të ndërmarrjes pastaj në emër të komunës. Kur është ndërtu objekti i ambullantes ka qenë pronë e shtetit

**Hamit Lima:** A ka qenë kontekst gjyqësor?

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Bashkim Krasniqi:** Ne si Kadastër nuk jem të informum për qdo konteks gjyqësor, përveq kur kemi mas të përkohshme që duhet me u regjistru në librat kadastral. Shënime zyrtare, vërejtje, masë e përkohshme, vendim gjykate nuk ka pasur të rexhistrum

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit- Muharrem Morina:** Ndërmarrja që është kriju aty në kohën e ish sistemit ju ka marr pronat private qytetarëve dhe ka krijuar një ndërmarrje, pastaj ato prona komuna i ka qit mbi vete, mirëpo pronarët i kanë të dhënat e veta, historiat i pronësisë i ka të dhënat që ish sistemi i ka marrur ato prona.

**Veton Zogaj:** Ky problem në vazhdimësi po e përcjelll komunën. Është mirë me bërë listën e pronave të ish ndërmarrjes Mirusha dhe të na vijë dhe ta shohim cilat prona janë në kuadër të kësaj. Me sa di unë komuna asnjëherë nuk e ka bartur pronësin ne shumë prona tjera, psh shkollat. Shkolla në LLadroc, ku ka qenë shkolla e vjetër në ish systemin personit që e ka lëshuar pronën për shkollë, ati fshati ja ka kompenzuar dhe pas lufte është djegur ajo shkolla atje dhe personi dhe atëherë a kompenzu dhe pas lufte e ka pasur pronësi të vetën dhe e ka shit te një banor privat. Pronën e njejtë e ka shit dy herë. As shkolla aktuale në Lladroc nuk është pronë e komunës, është pronë e një qytetari qe e ka lëshuar pronën dhe ju ka kompenzuar diku tjetër, marrveshje gojore. Kemi dhe prona tjera që do na dalin probleme tjera është dhe stacioni i policies.

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Bashkim Krasniqi:** Këtu nuk kemi të bëjmë me pronë të AKP-së, por me pronë komunale. Ka dhe shumë padi që janë në process.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** A jemi në rregull me dokumentacion që këtë pikë ta rekomandojm për kuvend

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit Muharrem Morina:** Në aspektin Ligjor, sa i përket dokumentacionit që ju posedoni jemi në rregull, ndërsa qka ka ndodh në Gjykatë dhe para Gjykate ne nuk kemi përgjegjësi.

**Hamit Lima:** Komuna a ska mundësi me bërë ankesa

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Bashkim Krasniqi:** Unë e kam një vendim të pales, unë nuk kam qënë pjesë e procedurës.

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit Muharrem Morina:** Kur është një precedent në drejtësi Gjykata paraprake që e ka marr një aktgjykim, gjykata pasuese e zbaton precedentin.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është që Kërkesa 02/207, për kompenzimin e pronës private me pronë publike sipas Ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të paluajtshme të komunës, të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa 02/203, për marrje të pëlqimit për vendosjen e betonjerkes në fshatin Dragobil.

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit Muharrem Morina:** Është mirë mos me ndal këtë invsitor. E jepni pëlqimin në asamble, ky quhet pëlqim komunal dhe me këtë ka me apliku në ministrin e mjedisit që i merr pesë leje, mirëpo pa e pas këtë Ministria e ambientit nuk e jep. Ministria e ambientit e ka për obligim me ardh me mbajt nje debat me qytetar, sepse ky investim a ka ndikim në mjedis në rrethin ku planifikohet me u ndërta dhe pastaj ja japin lejen e punës.

**Hamit Lima:** Pasi ata paskan të drejtë me diskutu me qytetarët, pse ne mos me bërë dhe atë.

**Zyrtari Ligjor i kuvendit Muharrem Morina:** Nëse qytetarët reagojn Ministria nuk ia jep pëlqimin mjedisor.

**Hamit Lima:** Pse së pari se bëjmë ne.

**Zyrtar Ligjor i Kuvendit Muharrem Morina:** Me Ligj nuk kërkohen ne me bërë, ministria e ka këtë pjesë.

**Hamit Lima:** Ne mundemi si përfaqësues të atyre qytetarëve me diskutu me marr një pelqim prej fshatit.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Hamit, janë procedurat ligjore.



**Veton Zogaj:** Aty ka lagje është memoriali dhe ne me dërgu një betonjerk aty dhe duke e ditur praktikën se si i bëjnë dëgjimet publike me qytetarët bizneset e tjera, e vendos një shpallje publike që nuk e dinë as ku ekziston ajo shpallje, i bënë 2-3 banorë të zonës dhe thotë e kreu këto punë, procedurat tjera i krye shkel e shko. Unë në këtë pikë abstenoj dhe besoj që në kuvend nëse shkon edhe votojm kundër sepse ai territory ku po dëshiron me hap, unë mendoj që 4-5 vitet e ardhshme Malisheva do të zgjerohet deri atje. Unë të paktën nuk dua të bëhem pjesë në të ardhmen e një vendimi që e dëmton jetën e qytetarëve.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Në parim është që si komunë mos ka plan zhvillimor për tu bërë aty, ne vetëm për këtë fakt kemi me dhënë pëlqim. Komuna plan zhvillimor nuk ka të planifikuar aty.

**Veton Zogaj:** Unë mendoj që shumica e lejeve që janë dhënë. qoftë për betonjerka apo gurthyes kanë qenë vendime të gabume. A kanë pasur inpakt në zhvillim, në dëmtimin e shëndetit publik kjo nuk don as diskutim. Betonjerka që është në Mirushë, tjetra në Dragobil, Bubavec janë në qendër të fshatit mirëpo janë vendime të gabume, përgjegjësia kalon tek ata që kanë marr këso vendime. Në atë lokacion kemi marrur vendim për me dërgu stacionin energjetik aty.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për kuvend kërkesa nr.02/203 të rekomandohet për Kuvend?

Për:4

Kundër:1

Abstenim:1

Kërkesa 02/179, për marrjen e pëlqimit për ripërkufizimin e kufijëve të parcelës në të cilën është e ndërtuar objekti afarizëm dhe banim, shfrytëzues 1 përhershëm 1 të cilës është organizata e pensionistëve.

**Zyrtari Ligjor Muharrem Morina:** Në 2011 kuvendi ia ka ndar 5 ari shoqatës së pensionistëve dhe kjo shoqat nuk ka pasur donacion me ndërtu dhe ka hyrë me një biznes privat me kompenzim me ndërtu. Ky objekt futet brenda zonës kadastrale, hynë në process të legalizimit.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për kuvend kërkesa nr 01/179?

Për:4 Kundër:0 Abstenim:2.

Kërkesa nr.02/209 e parashtruar nga Naim Dobruna, për lejimin e vendosjes së Lapidarit Latif Dobruna, i cili ka qenë banorë i komunës së Malishevës.

**Zyrtari Ligjor Muharrem Morina:** Naim Dobruna i kërkon 2 ari prej ekonomis së pyjeve në Llozicë me vendos pllakën për një antarë të familjes që është vuarë ne vitet 60-70. Ne e kemi dërguar në Ministri të pushtetit lokal dhe Ministria e ka përcjellë në Ministrin e Bujqësisë dhe ata e kanë leju 2 ari, mirëpo tani është procedurë që ju ato 2 ari do e bëni zonë me interes të veçantë.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.02/209?

Me vota unanime, rekomandohet për kuvend.

Prezent jemi 4 anëtarë

Kërkesa 02/17, kërkesa 02/529, kërkesa 02/342 dhe kërkesa nga Blerand Kryeziu, kush është për rekomandim për Kuvend?

Me vota unanime këto kërkesa rekomandohen për kuvend.

Kërkesa nr.02/134, kërkon nga Kpf ndihmë financiare për nënën Feride Krasniqi e cila është me kancer. Kush është që kësaj kërkesë t'i ndahen 500E?

Me vota unanime i ndahen 500E

Kërkesa nr.02/94 nga Xhilda Thaçi me kancer. Kush është që ti ndahen 400E?

Me vota unanime Xhilda Thaçi i ndahen 400E.

Kërkesa nr.02/99 Refki Krasniqi kërkon ndihmë financiare për shërimin e djalit Nebih Krasniqi, i cili e ka diagnozën të papërcaktuar nga mjekët dhe i duhet shërim i vazhdueshëm jashtë vendit. Kush është që Refki Krasniqi ti ndahen 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E

Kërkesa nr.02/183 e parashtruar nga Hajrie Morina, kjo është ndihmuar në muajin qeshor. Kush është për refuzim të kësaj kërkesë?

Me vota unanime kjo kërkesë refuzohet, pasi është ndihmuar në muajin qeshor.

Kërkesa e parashtruar nga Hajrie Shala e cila vuan nga shumë sëmundje të ndryshme dhe që 10 vite jam me oksigjen për frymarrje

Kërkesa nga Emrije Krasniqi Kush është që këtyre dy kërkesave të ju ndahet nga 450 E për secilën?

Me vota unanime miratohen këto kërkesa.

Kërkesa tjetër është nga Fetah Mazreku i cili kërkon ndihmë financiare për vajzën e tij e cila është e pa lëvizshme. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 400E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 400E.

Kërkesa e parashtruar nga Ukë Krasniqi. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 300 E?

Me vota unanime i ndahen 300E.

Kush është për që kërkesave:02/74, 02/613, 02/75,02/72, 02/225, 02/71 tu ndahen nga 300E seciles kërkesë?


Me vota unanime, këtyre kërkesave u ndahen nga 300E.

**Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.**

Mbledhja përfundoi në ora: 11:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



---

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaci

